01

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Fin...
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kos... a / Tax Administration of Kosova
Departamenti i Ankesave
Nr. Prot. 421/2022 Data 08/11/2022
PRISHTINË

Nr: 9037

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK) - Divizioni i Ankesave – në përbërje të panelit shqyrtues të kryesuar nga Flora Veliu- Ademi, anëtarë të panelit: Xhevdet Neziri dhe Emine Nikqi, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit tatimor [redacted] me numër unik identifikues (NUI)[redacted] me pronar [redacted] me adresë të biznesit: Rruga Bedri Shala - Gllogoc, e dorëzuar ne Divizionin e Ankesave me datë: 30.09.2022 me nr. të protokollit 421/2022, kundër Vendimit mbi lëshimin e gjobës nga Zyra Zgjona me nr. te protokollit: 1921/2022 datë 31/08/2022 në vlerë prej 623.00€; në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 21.10.2022 në prezencë të palëve: tatimpaguesit nuk ka prezantuar ne seance: inspektori i kontrollit: Luan Ajeti, Inspektori/e i Zgjona-s : Xhevahire Parllaku; Zyrtari/a nga zyra e avokatit te tatimpaguesit: Valbonë Syla mori këtë:

VENDIM

I. Refuzohet si e pabazë ankesa nr. 421/2022 dt: 30.09.2022 e tatimpaguesit në procedurë [redacted] me numër unik identifikues (NUI)[redacted] me pronar [redacted] me adresë të biznesit: Rruga Bedri Shala - Gllogoc, në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe,

II. Vendimi nr.1921/2022 i datës 31.08.2022 në vlerë prej 623.00€, lëshuar nga Zgjona e Administratës Tatimore të Kosovës – në Prishtinë vërtetohet si i bazuar.

III. Procedura e ankesës nuk ndërprenë obligimin e tatimpaguesit për pagesë të detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkim dhe interes) në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-102 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Arsyetim

Tatimpaguesi me datë 31/08/2022, është ndëshkuar, ndëshkimin e ka pranuar më datë (01/09/2022) dhe i njëjti në afatin ligjor sipas nenit 77.2 të Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurën , ka parashtruar ankesë në Divizionin e Ankesave me datë 30/09/2022 me nr. të protokollit 421/2022, duke kundërshtuar vendimin mbi lëshimin e gjobave (lirimin nga 50% për gjobën Mall pa origjinë – vlerën 1,992.00*25% = 498.00€) nga Zyra Zgjona – Prishtinë

me nr. te protokollit: 1921/2022; te datës 31/08/2022. Specifikisht tatimpaguesi kërkon përfitimin e zbritjes te shumes se gjobës 50% për mall pa origjinë.

Tatimpaguesi në ankesë potencon: Subjekti tatimor "[redacted] me NUI: [redacted], me seli të biznesit në Rr. Bedri Shala p.n. Gllogovc, me pronar z. [redacted] duke u bazuar ne Nenin 77 te Ligjit 03/1-222 dhe Neni 44 te Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2010 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat brenda afatit ligjor parashtron ankesë kundër Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative (Zgjona) me nr. Protokolli 1921/2022 i datës 31.08.2022 pranë Administratës Tatimore të Kosovës për ndaljen e mjeteve 100.00 % te ndëshkimit prej 25% për mallrave pa origjine - sipas legjislacionit tatimor dhe rregullorja e brendshme e ATK-së nr. 01/2022 e cila fillon te zbatohet nga data 01.02.2022 nëse paguhet 50.00 % gjoba mandatore dhe ndëshkimi prej 25% për mallrave pa origjine brenda 15 ditëve 50.00% e gjobës dhe ndëshkimi zbritet. Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime administrative (Zgjona) me rastin e ndalesës se ndëshkimeve te subjektit nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ka aplikuar gabimisht dispozitat ligjore dhe ka bere dëmtimin material të subjektit tatimor duke e ngarkuar me ndalesën e 50.00 % te ndëshkimit mos fshirjes se vlerës 249.00€ pas konstatimit te mallrave pa origjine ne vlerë prej 1,992.00 * 25% 498.00€ të pa bazuara.
Me date 26.08.2022 nga Inspektori tatimor kemi pasur një vizite ku me date 31.08.2022 nga Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime administrative (Zgjona) kemi pranuar Vendimin - Njoftim Vlerësimi me Nr. i Dokumentit: MFA2R1007598747L ne vlerë: 1,992.00*25% = 498.00€ dhe Njoftim Viersimi me Nr. i Dokumentit: MFA2R1007598746J ne vlerë: 125.00€ I bej tutje Administratës Tatimore te Kosovës - Departamentin e Ankesave qe te ketë konsideratë dhe te na bej te mundur pranimin - fshirjen e 50.00 % te Ndëshkimit me Nr. i Dokumentit: MFA2R1007598747L ne vlere 249.00€ (pasi qe 249.00€ janë paguar brenda afatit ligjore me Nr. i Dokumentit: MFA2R1007598747L, Llogaria Tatimore: 976578, Nr i Vlerësimit: 31936115) — konstatimit te mallrave pa origjine.
Nga arsyet e sipër cekura shihet qartë që Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, ku ka aplikuar ne mënyre të gabuar legjislacionin tatimor dhe si rezultat na dëmtuar materialisht me obligime tatimore shtesë, andaj i propozojmë Departamentit të Ankesave që pas analizimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave materiale në shkresat e lëndës, dëgjimit të palëve në seancën dëgjimore të merr këtë vendim te aprovohet kërkesa jone dhe te anulohet vendimi i Zgjonas.

Aktivitet i Inspektorit i datës 25/08/2022 – sipas aktivitetit AU005 është konstatuar se tatimpaguesi ka mall pa origjine ne vlere prej 1,992.00€ Për shkak të parregullsive qe kanë të bëjnë me mall pa origjine - mos mbajtje te libra dhe regjistrimeve sipas legjislacionit ne fuqi raporti dërgohet tek Zgjona.

Vendimi i Zgjona-s nr.1921/2022: Në përmbushje te aktiviteteve operative te përcaktuar nga ATK-ja me date 25.08.2022 nga inspektori tatimor është vizituar subjekti '[redacted]. ku janë përshkruar te gjitha rrethanat faktike dhe shkeljet te cilat janë konstatuar gjate vizitës tatimor tek ky subjekt. Ne baze te aktivitetit te inspektorit është konstatuar se tatimpaguesi ka poseduar mall pa origjine ne vlere prej 1,992.00. Zyra Zgjona pas analizimit të raportit nga tereni, dhe shkresave tjera te lendes konstaton se tatimpaguesi ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore Nenin 13 paragrafin 1 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-222, për Administratën tatimore dhe procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe 04/ L-223, neni

17 pika 1 dhe neni 19 paragrafi 4 i UA 15/2010 Ligj 03/L-222 te gjithë tatimpaguesit janë te obliguar te mbajnë libra dhe regjistrime, ashtu siq kërkohet me legjislacionin tatimor ne fuqi.

Divizioni i Ankesave në bazë të nenit 95 të Ligjit Nr. 05/L-031 'Mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative" ka organizuar seancë dëgjimore me datë 21.10.2022, në të cilën të pranishëm ishin Inspektori i kontrollit, inspektori i Zgjonas, ndërsa tatimpaguesi nuk ka prezantuar ne seance.

Administrata Tatimore - Divizioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës, shkresave në lëndë, pretendimeve në ankesë konstaton se: Ankesa e tatimpaguesit është e pa bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizioni të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim:
Divizioni i Ankesave pas verifikimit të shkresave në lëndë, si: AU005 dt.25.08.2022-aktiviteti i inspektorit tatimor gjatë vizitës në teren, vendimin nga Zgjona nr. 1921/2022 të dt.31.08.2022,
Te cekurave ne seance dëgjimore nga inspektori i kontrollit dhe Zgjona-s konstaton se tatimpaguesi është ndëshkuar në mbështetje të Nenit 53 par.2.1 në vlerë prej 125.00€, për shkak të mos mbajtjes së librave dhe regjistrimeve, dhe në bazë të Nenit 59, për shkak të konstatimit të mallit pa origjinë në vlerë prej 1,992.00€, të Ligjit Nr. 03/L-222, gjithsejtë ndëshkimi prej 25% në vlerë 498.00€, në total ndëshkimet 623.00€ (125+498=623.00).
Sa i përket kontestit te tatimpaguesit për lirim nga pagesa e 50% e vlerës se gjobës për mall pa origjinë DA duke u bazuar ne gjendjen e borxheve te tatimpaguesit, dhe fletëpagesave te bankës, si dhe dosjes se t/p, konstaton qe gjoba është paguar brenda afatit pesëmbëdhjete (15) ditësh, mirëpo tatimpaguesi ka bere pagesën vetëm 50% te vlerës se gjobës për mall pa origjinë. Gjë qe tatimpaguesi nuk ka gëzuar te drejtën për te përfituar nga pagesa e gjobës për pesëdhjete përqind (50%) e vlerës totale te gjobës, bazuar ne rregulloren e Zgjona-s te datës 01.02.2022, ndaj te cilëve Zgjona *shqipton gjoba fikse* për shkelje te legjislacionit tatimor, kanë mundësinë qe te përfitojnë zbritje nga pagesa e tërësishme e shumes se gjobës. Ne rast se tatimpaguesi paguan gjobën e shqiptuar brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga data e hyrjes ne fuqi te Vendimit nga Zgjona, tatimpaguesi lirohet nga pagesa e pesëdhjetë përqind (50%) te shumes se gjobës se shqiptuar dhe ne ketë rast procedura e ankimimit suprimohet dhe rasti konsiderohet i mbyllur. Andaj bazuar ne ketë rregullore tatimpaguesi mbetet obligues i pagese edhe për pjesën tjetër te gjobës vlerën 50% te papaguar!
Sipas vlerësimit të Divizionit të Ankesave, lëshimi i ndëshkimit për mallrat pa origjinë, është vërtetim i gjendjes faktike në momentin e caktuar kohor. Këtë konstatim inspektori i kontrollit e vërtetoi edhe me liste te numërimit te stokut te dërguar përmes emailit. Konstatimi i mallrave pa origjinë justifikohet me vërtetimin e gjendjes faktike gjatë vizitës operative të inspektorit tatimor gjatë vizitës me datë 25.08.2022, ku ka konstatuar se tatimpaguesi ka mallra pa orgjinë në vlerë prej 1,992.00€ dhe nuk ka dokumentuar origjinën e posedimit të mallit me as një dokument, siç parasheh neni 13, paragrafi 5 i ligjit nr.03/L-222 dhe neni 19 i Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 (si: faturë ,Dud-ë , kuponë apo pagesë).
-Neni 13, paragrafi 5, parasheh:" *mallrat në zotërim të një tatimpaguesi të jenë të dokumentuara mbi origjinën".*
-Kurse neni 19 parasheh: *Sikurse është përdorë në këtë Nen, termi, "Mallra" i referohet mallrave komerciale – atyre të cilat një person ka synim t'ia shesë apo furnizojë personit tjetër. Përveç për mallrat që përdoren nga një person në organizatën afariste, termi "mallra" nuk*

përfshinë gjësendet personale të individit. Paragrafi 5 i Nenit 13 të Ligjit, parashikon që mallrat në zotërim të një tatimpaguesi të jenë të dokumentuara mbi origjinën. Kjo nënkupton se një tatimpagues duhet të jetë në gjendje të ofrojë dokumentacionin mbështetës, i cili arsyeton prejardhjen e mallit si në vendndodhjen, apo vendndodhjet e tatimpaguesit, ashtu edhe për mallrat në qarkullim (jashtë vendndodhjes/eve të tatimpaguesit). Tatimpaguesi, duhet të jenë në gjendje të dokumentojë të gjitha mallrat nga koha e pranimit (qoftë përmes importimit, blerjes, apo shkëmbimit apo mënyrave tjera) deri sa ato të jenë shitur apo ndryshe të jenë sistemuar, përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemim tjetër.
Me këtë vërtetohet se tatimpaguesi ka bërë shkelje tatimore i cili ndëshkohet sipas nenit 59 të Ligjit Nr. 03/L-222, për "Administratën Tatimore dhe Procedurat".
Kjo dispozitë parasheh: "*Kur një person i angazhuar në aktivitet ekonomik posedon mallra pa orgjinë, ai person do t'i nënshtrohet ndëshkimit administrativ me njëzetepesë përqind (25%) të vlerës së tregut të mallrave*".
Vlera e mallrave pa dokumentacion është konstatuar 1,992.00€ x (here) njëzet e pesë për qind (25%) e kësaj vlere që është barazi 498€ -gjegjësisht ndëshkim administrativ.
Po ashtu për mos krijim e librave dhe regjistrimeve-gjegjësisht mungesës së regjistrimeve (pasi nuk ka mbajtur as një regjistrim të librave, as fatura të blerjes dhe as të shitjeve) sipas nenit 13 të Ligjit nr.03/L-222, tatimpaguesi është ndëshkuar me gjobë prej 125.00€ në mbështetje të nenit 53 par.2.1 i ligjit nr.03/L-222.

Në bazë të gjendej së konstatuar duke pasur parasysh të gjitha provat të cilat gjendën në shkresat e lëndës, e në përputhje me nenin 132, paragrafi 2, i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Divizioni i Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222, tatimpaguesi pakënaqur ka të drejtë që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të vendimit të Divizionit të Ankesave , ta kundërshtojë këtë vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr:421/2022 datë 08/11/2022

Vendimi t'iu dorëzohet :
1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi _____

Kryesuese e rastit
Flora Veliu- Ademi _____